

VENDIM
Nr.20, datë 13.1.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726, DATË 23.11.2005 “PËR SHPRONËSIMIN
PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QAFË-
KASHAR-RINAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6 e vendimit nr.726, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.3.2006”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha